



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 73-të të mbajtur më 18.08.2022 ka miratuar si në vijim.

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-3446/1 të datës 17.09.2021 në lidhje me Raportin përfundimtarë të dorëzuar për auditimin e kryer nga Enti shtetërorë i revizionit, HIDHET POSHTË.

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-3446 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga ana e Entit Shtetërorë i Revizionit më 17.09.2021 është dorëzuar një ekzemplarë i Raportit përfundimtarë i revizorit të autorizuar shtetërorë për revizionin e kryer për Revizionin e Raportit Financiar Total me specifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në fushatën elektorale, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë së ----- për fushatën elektorale për Zgjedhjet Paraprake Lokale dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Komunës së Shtyp dhe Pllasnic 2020, pas së cilës u formua lënda me numër 12-3446/1 i datës 17.09.2021.

Në Raportin përfundimtar të dorëzuar nga Enti Shtetëror i Auditimit në lidhje me raportin financiar të partisë politike të përmendur, në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e raportit financiar, është konstatuar se në të njëjtën nuk janë shprehur të ardhurat dhe shpenzimet për reklamimin politik të paguar në bazë të kontratave të asigimit, të cilat nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve janë paguar drejtpërdrejt radiodifuzorëve, ndërsa për pjesën e pajtueshmërisë me rregullimin ligjor, udhëzimet dhe politikat e vendosura, Enti Shtetëror i Auditimit shpreh mendim pa rezervë.

Pas kësaj, nga Enti Shtetëror i Auditimit u është dhënë rekomandim organeve kompetente të partisë, në proceset e ardhshme elektorale, që të realizojnë qarkullimin e

pagesave me asignim nëpërmjet një llogarie transaksioni, si dhe që të ardhurat dhe shpenzimet e reklamimit politik të paguar t'i shprehin në raportin financiar për fushatën elektorale.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lëndës, KSHPK-ja konstatoi se në rastin në fjalë bëhet fjalë për aktivitet të rregullt të Entit Shtetëror të Revizionit, e cila sipas nenit 85-b paragrafin (7) të Kodit të Zgjedhjeve, ka detyrimin të dorëzojë raportet e revizionit të revizioneve të kryera në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe në KSHPK.

Në raport nuk janë konstatuar keqpërdorime financiare të partive politike-----, që është arsyeja pse një raport i tillë nuk siguron transparencë mbi të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës elektorale.

Kjo metodë e paraqitjes së raporteve financiare nga partitë në njoftimin e fushatave elektorale, për KSHPK-në përbën një situatë tashmë të përcaktuar dhe të konstatuar, e cila është kryesisht për shkak të faktit se me ligj nuk parashikohet mbajtja e trajnimeve për përfaqësuesit e partive politike për të mundësuar udhëzime të qarta për plotësimin e raporteve, veçanërisht nëse merret parasysh se një pjesë e madhe e partive nuk kanë punonjës dhe/ose përdorin ndihmën dhe shërbimet e të tjerëve.

Nga aspekti i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, KSHPK-ja konstatoi se veprimi i tillë nuk çon në sjellje korruptive nga ana e partive politike, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi

Përgatiti: K.Z  
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Kryetare,  
Biljana Ivanovska

